

HISTORIKU I SHFMU “VËLLEZËRIT DOMANEKU” TOPLIQAN

Historiku i shkollës sonë: Mësimet e para fëmijët e fshatit tonë i morën në mejtepe (mësonjëtoje fetare) nga tetori i vitit 1937 në lokalitetin e Shahin Elshanit. Mësohej alfabeti arab, me tekste turke, mësimdhënësi ishte shqiptar, Myftiu Abazi nga Prishtina. Moshë e nxënësve ishte 8 vjeçare. Më 1939 punon Hafuz Nazifi nga Kosharja-Ferizaj, më vonë Hafuz Jakupi nga Babushi, që të dy kishin qenë nxënës të mejtepit të Topliqanit. Mejtepi mbyllet më 1942, (LDB) për të filluar më 1947 në gjuhën shqipe me mësuesin Mulla Sabiti-Prekopuca nga Bujaria. Më 1953 vjen mësuesi Enver Retkoceri nga Llugaxhia. Në këtë vit edhe ndërtohet shkolla e re nga vetë fshatarët me materialin e kooperativave të kolektivit. (Sipas shënimit të mësuesit Feriz Sillova, i cili 43 vite punoi me ditar, tani në pension, e i cili i referohet konsultimeve të mësuesit Zenel Sopa, Grackë e Vogël).

Në vitin 1990 Gracka e Vogël ndërtoi shkollën dhe mësimi filloi me klasat 1-4 kombinim. Më 1991, kur okupatori serb okupoi shkollat, edhe në Lipjan nxënësit nga klasa 6-8 mësuuan në këtë shkollë. Më 1997 u ndërtua shkolla e re, me mjete vetanake, ku kontributi financiar i mërgimtarëve ishte vendimtar, falënderim fshatit dhe të gjithëve që ndihmuan në ndërtimin e shkollës.

Por lufta për liri ishte në radhë tani dhe të gjithë u angazhuam për frontin e luftës, të tillë luftëtar të lirisë ishin; Alie, Shefket, Bajram, Selman Daka, Gëzim, Besnik Shillova, Zyfer Sahitollari, Imri Gallopinin, ndërsa nga fshati Grackë e Vogel, Lulzim Duraku, Habib Mollopolci, Xhevat Sopa, Nexhmedin Sopa, Burim Sopa, ishin në frontin e luftës. Falë angazhimit, sakrificës dhe gjakut të bijave e bijve tanë të radhitur në UÇK, Kosova u çlirua.

Në periudhën më të hershme ishin edhe Vëllezërit Domaneku të cilët i dolën zot Atdheut kur i ishte kërcënuar liria.

Në vitin 2000 shkolla e re meremetohet falë Organizatës daneze “ADRA”, falënderojmë angazhimin e Fillit, inventarin e solli Organizata franceze “Atlas”, falënderojmë angazhimin e Mevlid Shillovës. Më 2005 pavarësohet shkolla, më 2009 emërtohet me emrin e vëllezërve: Islam, Xhem, Osman, Mustafë Domaneku që ranë në luftë me forcat jugosllave në përpjekje për të ruajtur Shqipërinë Etnike.

Tani shkolla jonë ka rreth 200 nxënës që marrin njohuri dhe edukohen në këtë vatrë. Këtu punojnë 17 punëtorë (14 mësimdhënëës).